REPUBLIKA E SHQIPËRISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Realizimin e Reformës Zgjedhore

Nr. 6819 prot. Tiranë, më 27.11.2026

Lënda: Kërkesë për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Realizimin e Reformës Zgjedhore.

Drejtuar: **Z. NIKO PELESHI, KRYETAR I KUVENDIT**

KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR PËR REALIZIMIN REFORMËS ZGJEDHORE

KONFERENCËS SË KRYETARËVE

I nderuar zoti Kryetar,
Të nderuar deputetë,

Kuvendi, me qëllim realizimin e një reforme zgjedhore të plotë dhe gjithëpërfshirëse, me vendimin nr. 74/2025, datë 27.10.2025, miratoi ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Realizimin e Reformës Zgjedhore, me përfaqësim të barabartë të shumicës dhe pakicës parlamentare.

Afati aktual i veprimtarisë së këtij Komisioni përfundon më 30 nëntor 2026.

Pavarësisht punës së zhvilluar deri më sot, diskutimeve, konsultimeve dhe angazhimit të ekspertëve teknikë, veprimtaria e Komisionit nuk ka avancuar me ritmin e nevojshëm për përmbushjen e plotë të objektivave dhe detyrave të përcaktuara nga Kuvendi.

Aktualisht, Grupi i Ekspertëve Teknikë ndodhet në një fazë të rëndësishme të punës për hartimin dhe finalizimin e disa projektligjeve, një pjesë e të cilave tashmë janë depozituar pranë Komisionit. Këto projektligje synojnë jo vetëm ndryshime në Kodin Zgjedhor, por edhe ndërhyrje në Kodin Penal, përmirësimin e kuadrit ligjor për financimin e partive politike, si dhe në legjislacionin tjetër që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me procesin zgjedhor.

Shqyrtimi i këtyre projektligjeve, diskutimi në nivel teknik dhe politik, konsultimi me aktorët e interesuar dhe arritja e dakordësisë ndërmjet palëve kërkojnë kohë shtesë.

Njëkohësisht, një pjesë e konsiderueshme e rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it, të evidentuara në raportet për zgjedhjet vendore të 14 majit 2023, zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025 dhe proceset e mëparshme zgjedhore, mbeten ende të patrajtuara ose të papasqyruara në legjislacionin përkatës. E njëjta nevojë për shqyrtim dhe reflektim ekziston edhe për rekomandimet e Këshillit të Evropës apo asistencës teknike Komisionit të Venecias dhe të partnerëve të tjerë ndërkombëtarë.

Në këtë drejtim, vlerësojmë gatishmërinë e vazhdueshme të OSBE/ODIHR-it, Bashkimit Evropian, Këshillit të Evropës dhe partnerëve të tjerë ndërkombëtarë për të asistuar Kuvendin e Shqipërisë në realizimin e reformës zgjedhore, përfshirë angazhimin dhe praninë e ekspertëve ndërkombëtarë në Shqipëri gjatë këtyre ditëve.

Përfundimi i mandatit të Komisionit në këtë fazë të punës do të rrezikonte të linte të papërfunduar një pjesë të rëndësishme të procesit legjislativ dhe të mos mundësonte shfrytëzimin e plotë të asistencës teknike ndërkombëtare.

Zgjatja e afatit të veprimtarisë së Komisionit do të mundësonte:

- Përfundimin e hartimit, shqyrtimit dhe diskutimit të projektligjeve të përgatitura nga ekspertët teknikë;
- Trajtimin dhe adresimin e plotë të rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it dhe Këshillit të Evropës;
- Përmirësimin e kuadrit ligjor për parandalimin dhe luftimin e krimeve zgjedhore, financimin e partive politike dhe keqpërdorimin e burimeve shtetërore në zgjedhje;
- Vijimin e konsultimeve dhe të bashkëpunimit me ekspertët dhe partnerët ndërkombëtarë;
- Krijimin e kohës së nevojshme për diskutimin dhe arritjen e dakordësisë politike mbi çështjet themelore të reformës zgjedhore.

Për sa më sipër, në cilësinë e bashkëkryetarit të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Realizimin e Reformës Zgjedhore, në emër të Partisë Demokratike dhe përfaqësuesve të opozitës në këtë Komision, **kërkoj zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit për një periudhë shtesë prej rreth 2-3 muajsh.**

Kjo zgjatje vlerësohet e nevojshme për të mundësuar përmbushjen e mandatit të ngarkuar nga Kuvendi, adresimin e rekomandimeve ndërkombëtare dhe realizimin e një reforme zgjedhore të plotë, gjithëpërfshirëse dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare për zgjedhje të lira dhe të ndershme.

Duke ju falenderuar,

BASHKËKRYETARI I KOMISIONIT
Oerd BYLYKBASHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Nr. 6821 Prot. Tiranë, më 27.11.2026

Lënda: **Propozohet një projektligj për shqyrtim dhe miratim nga Kuvendi**

Drejtuar: **Z. Niko PELESHI**
Kryetar i Kuvendit

Tiranë

Z. Kryetar i Kuvendit,

Në mbështetje të Kushtetutës dhe të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, bashkëngjitur do të gjeni projektligjin "***Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar***", të shoqëruar me relacionin e tij.

Kjo nismë ligjvënëse paraqitet nga një grup deputetësh të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, kërkojmë nisjen e procedurave parlamentare për shqyrtimin dhe miratimin sa më parë të këtij projektligji nga Kuvendi i Shqipërisë.

Duke ju falenderuar,

DEPUTETËT

Eno Bozo

Kostriot Irvali

Illadiana Gopje

Zijo Isuli

Igli Caro

Ledina Alolli

Jonida Tabaku

Saimir Zamerlin

Bujar Leskaj

Luan Baçi

Trit Shuk

Gjeta Bendeli

BELIND KËLLIÇI

[Shqiptarja.com]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Nr. 6820 Prot. Tiranë, më 27.11.2026

Lënda: **Propozohet një projektligj për shqyrtim dhe miratim nga Kuvendi**

Drejtuar: **Z. Niko PELESHI**
Kryetar i Kuvendit

Tiranë

Z. Kryetar i Kuvendit,

Në mbështetje të Kushtetutës dhe të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, bashkëngjitur do të gjeni projektligjin "***Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar***", të shoqëruar me relacionin e tij.

Kjo nismë ligjvënëse paraqitet nga një grup deputetësh të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, kërkojmë nisjen e procedurave parlamentare për shqyrtimin dhe miratimin sa më parë të këtij projektligji nga Kuvendi i Shqipërisë.

Duke ju falenderuar,

DEPUTETËT

Eno Bozo

Kastriot Pirolli 2020

Klodiana Sopjo

Zijai Ismailo

Iglo Cara

Ledina Aldi

Jeride Tabaku

Saimir Kamerho

Bujar Leskaj

Luan Baçi

Tvt

Gjeta Bendeli

BELIND KËLLIÇI

[Shqiptarja.com]